



KOMITETI OLIMPIK SHQIPËTAR

Lënda: Monitorimi në kohë reale i performancës dhe aktivitetit sportiv për fuqizimin e indeksit atletik dhe rritjen e cilsisë së jetesës së praktikuesve të sportit

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	2
1. PËRFITUESI / AUTORITETI KONTRAKTUES	3
2. QËLLIMI	3
3. OBJEKTI	3
4. QËLLIMI I PUNËS	4
4.1. Të Përgjithshme.....	4
1.1.1. Përshkrimi i detyrës	4
1.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet	4
1.1.3. Siguria e sistemit.....	5
4.2. Detyrat specifike	5
5. LOGJISTIKA DHE KOHA	6
5.1. Vendndodhja	6
5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave	6
6. RAPORTIMI.....	6
6.1. Kërkesat e Raportimin.....	6
6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve	7
7. SPECIFIKIME TEKNIKE.....	7
8. TABELA E ZËRAVE DHE ÇMIMEVE	9
9. DORËSZIMI I OFERTAVE.....	9
10. AFATI I APLIKIMIT	10

1. PËRFITUESI / AUTORITETI KONTRAKTUES

- **KOMITETI OLIMPIK KOMBËTAR SHQIPTAR (KOKSH)**

2. QËLLIMI

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar synon të trajtojë zhvillimin e një projekti eksperimental për promovimin dhe përfshirjen në aktivitetet sportiv me fokus të veçantë për të rinjtë, si dhe për vlerësimin dinamik dhe vazhdueshëm të parametrave jetikë të praktikuesve të sporteve të tjera, të segmentuara në grupime. Me qëllimin kryesor përmirësimin e cilësisë së jetës dhe promovimin e një ndërgjegjësimi të ri për gjendjen shëndetësore.

Projekti do të përqendrohet në përputhjen e teknologjive të reja (të tilla si ato të veshjeve) të afta për të zbuluar dhe monitoruar treguesin e shëndetit dhe performancës në kushtet e zakonshme të jetesës (sportive) me metoda të reja analizimi, për të personalizuar programet e trajnimit dhe aktivitetet mbështetëse, duke rritur vlerën e aktiviteteve sportive me mbrojtjen maksimale të shëndetit dhe të rritjes së të rinjve, si dhe për të përshtatur llojin më të përshtatshëm të aktiviteteve sportive për popullatën e rritur, duke parandaluar sëmundjet dhe duke rritur koeficientin e shëndetit publik.

Projekti eksperimental do të konsistojë në hartimin dhe zbatimin e një modeli shërbimi për të demonstruar dhe përkthyer në rezultate të prekshme, potencialin e krijimit të vlerës për shëndetin publik që rrjedh nga praktikimi i sportit në segmente të ndryshme të popullsisë dhe që mundëson logjikën e bashkëpunimit midis politikave të promovimit dhe marrjes me sport me politikën e shëndetit publik të parandalimit dhe të analizimit.

3. OBJEKTI

Projekti eksperimental synon vënien nën “monitorim shëndetësor” të 200 individëve, të përzgjedhura mbi bazën e kriterëve të caktuar, me ndihmën e pajisjes “Bluzë inteligjente”. Kohëzgjatja e monitorimit shëndetësor do të jetë afërsisht 12-14 javë të praktikës sportive.

Objektivi kryesor i projektit nuk është vetëm pajisja me bluza inteligjente me sensor të teknologjisë inovative që lidhen me to, por dhe mbledhja e të dhënave gjatë përdorimit të tyre dhe analizimi i këtyre të dhënave.

Për më tepër ky projekt eksperimental ka si qëllim projektimin dhe menaxhimin e shërbimeve për të përmirësuar praktikën sportive dhe mbrojtjen e shëndetit të sportistëve, që do të rezultojnë në vlera të prekshme, së pari për Komitetin Olimpik Kombëtar Shqiptar, për vizibilitetin dhe reputacionin e tij, si dhe për Qeverinë Shqiptare duke lehtësuar integrimin e praktikave sportive si mjete për reduktimin e shërbimeve mjekësore dhe si rrjedhim të kostove të kujdesit shëndetësor.

Elementet themelore që frymëzojnë këtë iniciativë të projektit eksperimental janë si më poshtë:

- Përhapja e rëndësisë së aktivitetit fizik dhe sportit, si element kyç për zhvillimin e mirëqenies psiko-fizike të individit;

- Përhapja e kulturës së ndihmës së parë dhe kujdesit shëndetësor, si për të nxitur zhvillimin dhe bashkëpunimin. si dhe përgjegjësinë kolektive;
- Parandalimi i rreziqeve individuale shëndetësore dhe ngjarjeve traumatike;
- Mundësimi i modeleve të reja të stërvitjes për të rinjtë dhe të rriturit, bazuar në personalizimin e metodave dhe kohës;
- Mundësimi i identifikimit të hershëm të talenteve të reja, për të mundësuar "shoqërimin" e zhvillimit e aftësive më të mira atletike dhe aftësive taktike dhe konkurruese;
- Propozimi i modeleve inovative të analizës dhe indeksimit të parametrave që rrjedhin nga politikat intensive të rekrutimit në sport për të rinjtë në moshën shkollore, të mbështetura nga përdorimi i teknologjive mundësuese të veshjes;
- Përcaktimi i modeleve të vlefshmërisë së bazave të të dhënave përkatëse, duke iu referuar veçanërisht zhvillimit të shërbimeve të reja për të mbështetur shëndetin, sigurinë, mirëqenien e sportistëve, gjithashtu në lidhje me parandalimin dhe politikat e shëndetit publik, dhe mundësisht identifikimin e metodave për vlerësimin e përfitimeve që rezultojnë. nga shëndeti publik, si reduktimi i kostove të kujdesit shëndetësor.
- Përcaktimi i modeleve validuese të bazave të të dhënave përkatëse, duke iu referuar veçanërisht zhvillimit të shërbimeve të reja për të mbështetur shëndetin, sigurinë, mirëqenien e praktikuesve të sportit;
- Në lidhje me komitetet e tjera kombëtare dhe Olimpike dhe/ose federatat e sektorit homolog, si dhe me institucionet shëndetësore publike, identifikimi i metodave për vlerësimin e përfitimeve që rrjedhin nga ndarja e këtyre bazave të të dhënave.

4. QËLLIMI I PUNËS

4.1. Të Përgjithshme

Me ndihmën e këtij projekti KOKSH synon që të monitorojë në kohë reale 200 individë në lidhje me treguesit e shëndetit dhe performancës në kushtet e zakonshme të jetesës (sportive) me metoda të reja inovative analizimi, për të personalizuar programet e trajnimit dhe aktivitetet mbështetëse.

1.1.1. Përshkrimi i detyrës

Ky projekt do të realizohet duke u bazuar në disa hapa kohorë dhe funksionalë, që do të ketë një ndërthurje midis proceseve metodologjike dhe operacionale. Për realizimin e kësaj kontrate duhet të parashikohen edhe aktivitete informuese dhe trajnuese në lidhje mbi bazën dhe kushtet e përdorimit, si dhe të interpretimit të të dhënave. Një pjesë e rëndësishme e saj do të jetë edhe komunikimi me institucionet e interesuara dhe publikun e gjerë.

1.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Ky projekt do të shtrihet në të gjithë Shqipërinë, duke u mbështetur në shfrytëzimin e sinergjive me projektin ekzistues që po zbaton KOKSH, me financim të Qeverisë Shqiptare “Ekipet

Sportive në Shkolla”. Gjithsesi kontraktori duhet të përcaktojë kritere të tilla për përzgjedhjen e individëve, që sigurojnë një grumbullim dhe monitorimin sa më të besueshëm të të dhënave.

1.1.3. Siguria e sistemit

Sistemi i grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave do të ketë siguri të lartë, duke specifikuar mënyrat e aksesit të përdoruesve në sistem, ndarja në grupe përdoruesish (sportist, trajner, administrata e KOKSH, shkolla, institucione shkencore etj.) Përcaktimi i nivelit të sigurisë si dhe disponueshmërinë, integritetin dhe konfidencialitetin e sistemit bazuar në rregulloren e administrimit të Bazave të të Dhënave Shtetërore.

4.2. Detyrat specifike

Monitorimi i parametrave jetikë të praktikuesve të sporteve parashikon regjistrimin dhe konvertimin të dhënave në format dixhital. Ky regjistrim i këtyre të dhënave duhet të bëhet mbi bazën e një metodologjie, të bazuar në kritere shkencore. Për këtë arsye është mjaft e rëndësishme që puna të organizohet në mënyrë sa më të detajuar, ku sipas nevojës detyrat të ndahen në faza dhe në paketa specifike pune.

Për një zbatim sa më të mirë të detyrave që lidhen me monitorimin në kohë reale të performancës dhe aktivitetit sportiv për fuqizimin e indeksit atletik duhet të merren në konsideratë paketat e mëposhtme të punës (PP):

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	Mn
PP 1 – Faza Përgatitore								
1.1.	Planifikimi Metodologjik dhe Afatet Operacionale;							
PP 2 – Menaxhimi dhe koordinimi								
2.1.	Përcaktimi i indekseve të performancës dhe procedurat e mbledhjes së të dhënave;							
PP 3 – Regjistrimi i të dhënave								
3.1.	Përkufizimi i Modelit të të Dhënave dhe Projektioni i Algoritmit të Screening/Scouting.							
3.2.	Menaxhimi i projektit dhe kordinimi shkencor							
3.3.	Trajnim për trajnerë (trajnerë dhe mjekët e sportit)							
3.4.	Regjistrimi dhe ndarja e 200 praktikuesve të sportit;							
3.5.	Shërbimet Mbështetëse në terren							

PP 4 - Komunikimi								
4.1.	Aktivitete mbështetëse							
4.2.	Komunikimi							
PP 5 – Sigurimi i Produktit								
5.2.	T-Shirt Set (3 cope për çdo individ)							
5.2.	Njësi qendrore për Set							
5.3.	Mobile device							

5. LOGJISTIKA DHE KOHA

5.1. Vendndodhja

Kontraktori do të përcaktojë një bazë operative të projektit (proponohet Tirana), ndërsa komunikimi me bashkëpunëtorët dhe përfituesit do të kryhet kryesisht online, si dhe nëpërmjet garantimit të një sporti teknik në rast të probleme teknike.

5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Periudha kohore e zbatimit të kësaj kontrate do të jetë 1 vit nga data e nisjes së saj, duke përfshirë të gjitha hapat e zbatimit dhe të raportimit përfundimtar.

6. RAPORTIMI

6.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në shqip ose anglisht në origjinal dhe 3 kopje të printuara (për arsye mjedisore, kërkohet sa më pak kopje të letrës të jetë e mundur):

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi 10 faqesh duhet të prodhohet brenda 5 ditësh nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj p.sh. gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij / saj derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të perbehet prej 50 faqesh (teksti kryesor, duke përfshirë anekset). Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se 1 muaj para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njëjtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, inkorporimin e komenteve të pranuar nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në

anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Raporti përfundimtar duhet të përmbajë edhe:

- 1- Prezantim në PowerPoint të gjetjeve/rezultateve.
- 2- Video clip i të gjithë ecurisë dhe rezultateve të projektit (5 Minuta)

6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Presidentit të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar, i cili është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

7. SPECIFIKIME TEKNIKE

Për të arritur objektivat e sipërpërmendura kërkohet jo vetëm që të blejë produktin e kërkuar (bluzë inteligjente e pajisur me sensor), të pajisur me një aplikacion të personalizuar, por edhe të monitorojë në kohë reale performancën dhe aktivitetin sportiv, mbi bazën e një metodologjie shkencore.

- **Parametrat qe duhet të masë pajisja**

- 1- Gjurmë EKG (cilësi deri në 4000 mhz)
- 2- BPM (rrahjet e zemrës)
- 3- Të gjurmojë kurbën e aktit të frymëmarrjes
- 4- Shkalla e frymëmarrjes
- 5- Temperatura e trupit
- 6- Zbulimi i lëvizjes/rënies, frontale, anësore, e pasme
- 7- Zbulimi i goditjes
- 8- Zbulimi i posturës:
- 9- - Ndryshueshmëria e rrahjeve të zemrës
- 10- - Zbulimi i stresit

- **Teknologjia e përdorur**

- Parametrat trupor duhet të maten nga sensorë polimerikë të padukshëm te integruar brenda materialit të rrobës dhe po kështu të transferohen tek pajisja e kontrollit.
- Sinjali që del nga pajisja e sportistit duhet të kodohet dhe të transmetohet me anë të teknologjisë IOT (Internet of thing) në një mjedis dixhital të mbrojtur.
- Sinjalet e krijuara të pajisjes së veshur duhet të jenë të mbrojtura nga mjedisi dixhital, sinjali do të ruhet në një bazë të dhënash qe ndodhet ne Cloud dhe do të analizohet përmes algoritmeve dhe API-ve të dedikuara, me të gjithë sigurinë dhe selektivitetin e aksesit të rastit.
- Aplikacioni që benë analizimin përpunimin dhe nxjerrjen e te dhënave duhet të jetë në version: Windows app, Web based app dhe mobile app.


- **Specifikimet e bluzës inteligjente**

- Pëlhura mund të jetë me bazë organike ose sintetike, me përputhshmëri me lëkurën (pesha nën 90 gr. (Madhësia M për meshkuj)
- Të rehatshme për t'u veshur për përdorim të përditshëm të zgjatur: në thelb sportisti duhet të ketë perceptimin e veshjes së një veshjeje të zakonshme;
- Lehtë për t'u përdorur (nuk kërkohet teknikë e veçantë);
- Sensorë jo metalikë të futur në pëlhurë (me trashësi zero) dhe për këtë arsye të padukshëm, që funksionojnë të thatë (d.m.th. pa xhel përçues)
- Rrugë transmetuese polimerike, e printuar në pëlhurë
- Logoja mund të printohet mbi bluzë (madhësia e logos së gjoksit: 5x3,8cm, logoja e bardhë në sfond të kuq ana e zemrës
- Pëlhurat dhe materialet kryesore: lahen dhe miqësore me lëkurën
- maksimumi 5 shkopinj / kunjat metalike
- Protokollit i larjes: Temperatura maksimale 30°
- Koha e rekomanduar e larjes 30min

- **Specifikimet e paisjes së kontrollit të parametrave truporë**

- Sensor EKG+ Frymëmarrje
- BT4
- Cache + MicroSD
- Sensor accelerometers + gyroscope
- GPS + 4G

- **Skema logjike dhe software**



- **Njësia qendrore**

- Pesha e njësisë qendrore duhet të jetë nën 17 gr.
- Jetëgjatësia e baterisë duhet të sigurohet brenda 24 orëve nga vazhdimi i aktivizimit
- Gjatësia: nën 6.00 cm
- Gjerësia: nën 4.00 cm
- Lartësia: nën 1,5 cm

8. TABELA E ZËRAVE DHE ÇMIMEVE

NR.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi / njesi	Vlera Lekë pa TVSH
1	Faza Përgatitore	Ditë pune			
2	Menaxhimi dhe koordinimi	Ditë pune			
3	Regjistrimi i të dhënave	Ditë pune			
4	Komunikimi	Ditë pune			
5	T-Shirt Set (3 copë)	Copë	200		
6	Njësia qendrore	Copë	200		
7	Pajisje mobile (mobile device)	Copë	200		
Cmimi Total pa TVSH					
TVSH					
Cmimi Total me TVSH					

9. DORËSZIMI I OFERTAVE

Për të aplikuar në këtë thirrje ju lutem dërgoni ofertat tuaja në zarf të mbyllur në emër të Sekretarit të Përgjithshëm të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar Z. Gerti Shima, në adresën:

*Tirana Olympic Park
Rr. "Liman Kaba"
Tiranë, Shqipëri
P.O. Box 63*

10. AFATI I APLIKIMIT

- Propozimet duhet të dorëzohen në adresën e mësipërme deri në datë 14.07.2023 jo më vonë se ora 16:00.

-Fund-